

## FATMIR SINOIMERI

(1930 - 2002)

MULAJ T.

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm, Departamenti i Fizikës

Fatmir Sinoimeri u lind më 10 dhjetor 1930, në një familje me tradita patriotike. I ati i tij, Basriu, ishte jurist, i cili gjatë sundimit turk punoi me përkushtim si mësues për përhapjen e gjuhës shqipe në Shqipëri dhe në Kosovë; për këtë kontribut të veçantë të tij është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me medaljen 'Për veprimtari patriotike'.

Fatmiri, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në qytetin e Shkodrës. Në vitin 1949 mbaron me përfundime të shkëlqyera gjimnazin '28 Nëntori' dhe cilësohet maturant i mirë i vitit. Po këtë vit dërgohet për të ndjekur studimet e larta në degën e Fizikës në Universitetin e Varshavës, Poloni. Për arritjet shumë të mira gjatë studimeve të larta, Ministria Shqiptare e Arsimit e trajton me një bursë të veçantë. Pas përfundimit të studimeve kthehet në Shqipëri dhe emërohet pedagog, fillimisht në Institutin e Lartë Politeknik, dhe më vonë në Institutin e Lartë Mjekësor. Me hapjen e Universitetit të Tiranës më 1957, ai emërohet pedagog në Katedrën e Fizikës; për kontributin e veçantë pedagogjik dhe shkencor në vitin 1972 merr titullin Docent. Sipas politikave të kuadrit të asaj kohe, në vitin 1976 Fatmiri qarkullon në rrethin e Pukës, ku punon si mësues në shkollën e Mesme të Përgjithshme 'Migjeni'. Në vitin 1981 rikthehet pranë Katedrës së Fizikës së Përgjithshme, FShN, UT, ku punon deri në vitin 1991, kur doli në pension.

Gjatë gjithë karrierës së tij si pedagog dhe si mësues, Fatmiri është dalluar për aftësinë, vullnetin dhe pasionin në punë, si dhe për korrektësinë në marrdhëniet me studentët dhe me kolegët. Kudo ka punuar me përkushtim dhe ka qenë i pa kompromentueshëm. Ai ka qenë një nga hartuesit kryesor të



programeve të lëndës së Fizikës për degë të ndryshme të Fakultetit të Inxhinierisë (sot Universiteti Politeknik i Tiranës); ka zhvilluar leksione thuajse në të gjitha degët e këtij Fakulteti, si dhe në Fakultetin e Mjekësisë. Eksperiencën e gjatë në mësimdhënie e ka pasqyruar mjaft mirë në 19 tekste mësimore të hartuara vetëm prej tij ose si bashkëautor kryesor. Edhe kur doli në pension, nuk u shkëput nga puna me tekstet; disa prej tyre vazhdojnë të përdoren dhe sot në disa fakultete të UPT-së dhe UT-së. Gjatë hartimit të teksteve ka luajtur rolin e mësuesit për autorët e rinj, duke i orientuar ata për kapërcimin e vështirësive fillestare. Një punonjëse e Shtëpisë Botuese të Librit Universitar (SHBLU) ku janë botuar tekstet e Prof. Sinoimerit kujton: - *Rastësisht Prof. Sinoimeri ka qenë autori i parë me librin e të cilit fillova punën. Ishte teksti 'Fizika e Përgjithshme' për Fakultetin e Inxhinierisë (1987). Profesori vinte shpesh në Ndërmarrje dhe ndiqte ecurinë e procesit të botimit të tekstit. Durimi dhe kërkesat maksimale na vinin para përgjegjësisë, duke na detyruar të ishim sa më të saktë në çdo rresht ose paragraf; njëherësh, kjo na edukonte për të qenë këmbëngulës dhe kërkues ndaj vetes në punën tonë.*

Gjatë karrierës akademike, Prof. Sinoimeri me durim dhe kujdes ka ndihmuar asistentët e rinj për të hedhur hapat e para në mësimdhënie, sidomos ata që zhvillonin mësim në degët inxhinierike, ku pata nderin të isha edhe unë. Më kujtohet se sa kisha mbaruar Fakultetin dhe fillova punën si asistente pranë Katedrës së Fizikës së Përgjithshme, profesori jepte leksionet dhe unë zhvilloja seminarët me studentët e degës së Inxhinierisë Mekanike. Orët e para ishin shumë të vështira; e vetmja eksperiencë që kisha ishin orët e seminareve gjatë kohës kur isha studente. Ndihma e profesorit në këtë periudhë ishte shumë e çmuar. Ai nuk përtonte të asistonte në orën e mësimin, dhe në fund me shumë kujdes e takt të jepte këshilla për ta organizuar më mirë atë orë. Po në të njëjtën mënyrë, kërkonte që edhe ne të rinjtë të asistojmë në leksion kur ai spjegonte, në mënyrë që të përfitojmë nga eksperiencia e tij.

Prof. Sinoimeri me pasjon dhe përkushtim zhvilloi një aktivitet të gjerë shkencor në fushën e Fizikës së Zbatuar. Me gjithë vështirësitë për shkak të mungesës së bazës laboratorike, ai punoi në drejtim të pasurimit të rërave me metoda elektromagnetike, si dhe në studimin e ndikimit të ultratingujve në aftësinë mbirëse të disa farave.

Kujtimi për Prof. Sinoimerin mbetet gjithmonë i freskët prej nesh me fuqinë dhe gjallërinë që e karakterizonte deri në ditët e fundit të jetës akademike, i qëndrueshëm në kërkesat ndaj vetes, bashkëpunëtorëve dhe studentëve.